



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2109/2 prot.

Datë 29.08.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-76323-07-28-2023 me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit(SMP)”, me fond limit 5.870.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor Sh.A Albpetrol.

**Ankimues:** “InfoSoft Office” SHPK  
Kashar, Kodër Kashar, Autostrada Tirane Durrës, Km 8, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol sha  
Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

Në datën 28.08.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3383 dhe me nr. 2109 prot., datë 28.08.2023 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; **b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;** c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori

ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik elektronik A/2023/3383 dhe me nr. 2109 prot., datë 28.08.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

*“Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, nuk ka deklaruar çertifikimin e 2 punonjësve të cituar në deklaratë. Gjithsesi, nga shqyrtimi në tërësi të dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezultoi se:*

- për punonjës të Medrisi Kuka nuk është paraqitur asnjë certifikatë,*
- për punonjës të Flavio Berberi është paraqitur certifikata si teknik servisi vetëm nga prodhuesi Lexmark.*

*Ofertuesi, për pajisjet Ricoh dhe Konica Minolta, të deklaruara në ofertë, nuk ka paraqitur asnjë punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve të paraqitura në ofertë ose me certifikatë ekuivalente të lëshuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, kjo në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të DST”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 29.08.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**